

Raporti Vjetor 2019

29 maj 2020

VIZIONI YNË

Një Shqipëri me komunitete rurale të gjallëruara, përfshirëse, pjesëmarrëse, aktive dhe kontribuese për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës.

MISIONI YNË

Formësimi i një zëri të qartë, efektiv e të qëndrueshëm në mbështetje të komuniteteve rurale sipas filozofisë së zhvillimit rural të udhëhequr nga komuniteti.

PARIMET e promovuara nga ANRD janë të bazuara në praktikat e mira evropiane:

- Zhvillimi i qëndrueshëm rural social dhe ekonomik, me bazë territorin dhe veçantitë specifike të tij, duke aktivizuar komunitetet e mbetura pas në proceset e zhvillimit përmes qasjes nga poshtë-lart që fuqizon aktorët dhe rrit pjesëmarrjen e tyre;
- Qasja e integruar ndërsektoriale dhe shumëaktorësh në dobi të zhvillimit rural, përmes rrjetëzimit, shkëmbimit të përvojave dhe ndërtimit të partneriteteve lokale duke shfrytëzuar idetë inovative;
- Financimi dhe menaxhimi i projekteve lokale nga burime të ndryshme financiare si kontribut dhe konfirmim i kredibilitetit dhe rëndësisë së projekteve lokale.

“Duke ndërtuar mbi çfarë është arritur përgjatë dekadës së fundit nga aktorë të ndryshëm zhvillimorë, duke validuar përpjekjet e mëparshme zhvillimore deri tani, ndërkohë që shfrytëzojmë mundësitë që ofron procesi i integritit evropian dhe optimizojmë bumrimet dhe rrjetet ekzistuese, ANRD do të përpiqet që të avancojë më tej agjendën rurale kombëtare nëpërmjet angazhimit në proceset e hartimit dhe zbatimit të politikave të sektorit, ndarjes së njohurive dhe transferimit të know-how, ndërtimit të partneriteteve dhe simulimit të Grupeve Lokale të Veprimit sipas qasjes Leader”

(Korniza Strategjike e ANRD, 2018-2020)

“Nëse Shqipëria dëshiron të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm [në fushat e punësimit, mjedisit, arsimit, shëndetësisë] duhet me patjetër që t’i ofrojë më shumë hapësirë dhe mbështetje grave në zonat rurale.”

Z. Brian J. Williams, Përfaqësues i Përhershëm i UN në Shqipëri duke adresuar pjesëmarrësit në Edicionin i I-rë të 'Pro Grave Rurale' | 15 tetor 2019, Qendra Rinore e Tiranës

"Ju faleminderit [grave rurale] për punën që bëni me shumë vështirësi. Na duhen politika më të mira, akses më i lartë, sepse është e vërtetë që mundësitë e grave rurale janë të pakta. Prandaj fokusi ynë, duhet të jetë pikërisht ky."

Zj. Eglantina Gjermeni, Deputete e Kuvendit të Shqipërisë, anëtare e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin gjatë fjalës përshëndetëse në Edicionin i I-rë të 'Pro Grave Rurale' | 15 tetor 2019, Qendra Rinore e Tiranës.

"Barazia gjinore dhe përkrahja e gruas janë pika kryesore në politikat e BE. Sot në Ditën Ndërkombëtare të Gruas Rurale, është momenti të reflektojmë sesi mund t'i ndihmojmë gratë rurale të luftojnë varfërinë."

Z. Razvan Ghitescu, Oficer Programi për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Delegacion i Bashkimit Evropian. Edicioni i I-rë të 'Pro Grave Rurale' | 15 tetor 2019, Qendra Rinore të Tiranës.

“ANRD konsiderohet partner i besueshëm dhe një instrument në procesin e zbatimit të Programit IPARD”

Z. Grigor Gjeci, Drejtor i Programimit dhe Monitorimit të IPARD, Autoriteti Menaxhues i IPARD në Tryezën Kombëtare mbi Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 12 shkurt në ambientet e EU House.

Letër nga Koordinatorja Kombëtare

2019 shënon vitin e tretë të rritjes dhe zgjerimit të ANRD e cila simbolizon një nismë genuine të shoqërisë civile për mirëqenie të përmirësuar të komuniteteve rurale. Përpjekjet e deritanishme kanë reflektuar gatishmërinë për të mbështetur dhe kontribuar në zbatimin me sukses të politikave dhe instrumenteve të zhvillimit të qëndrueshëm rural. Në këtë kontekst, ANRD ka nxitur ndërtimin e një agjende aktive, gjithëpërfshirëse dhe me dy kahe të zhvillimit rural në vend duke përfshirë qasjen Leader/CLLD (Zhvillimi Vendor i Udhëhequr nga Komuniteti), bujqësinë e qëndrueshme, gratë dhe të rinjtë, fermat familjare, agri-turizmin, sipërmarrjen e gjelbër etj.

Në këto tre vite (2016-2019) ANRD është rritur nga katërmëdhjetë organizata themeluese në më shumë se njëzet organizata anëtare, të cilat janë aktive në tematika të ndryshme të zhvillimit rural dhe zona të ndryshme gjeografike të vendit. Njëmendësia dhe vizioni i përbashkët i organizatave anëtare të ANRD për të avancuar rolin e shoqërisë civile në agjendën rurale të vendit, ka nxitur angazhimin e ANRD në proceset dhe reformat e zhvillimit rural dhe bujqësor.

Përgjatë vitit 2019 ANRD ka treguar një rol të rritur në proceset reformuese të sektorit nëpërmjet angazhimit në analiza dhe monitorimin e politikave publike të sektorit, në nisma advokuese me pjesëmarrje dhe me orientim nga poshtë-lart si dhe të bazuara në evidencë, në rritjen e kapaciteteve të organizatave vendore, në krijimin e partneriteteve të gjera publike-private dhe në rrjetëzimin e aktorëve në nivele të ndryshme.

Jemi entuziastë me interesin dhe besimin e grupeve të interesit dhe komuniteteve vendore për të intensifikuar përpjekjet tona në lidhje me ofrimin e një perspektive të unifikuar të interesave dhe prioriteteve të grupeve të ndryshme të popullatës rurale, për t'u lidhur dhe ndikuar politikat dhe veprimet e qeverisë dhe të aktorëve të tjerë. Në këtë kontekst, ANRD ka inicuar nisma dhe procese që avancojnë interesat dhe prioritetet e komuniteteve rurale dhe përshpejtojnë proceset reformuese të sektorit.

Viti 2019 shënoi hapa të rëndësishëm në prezantimin e qasjes ndërsektoriale dhe shumëaktoriale të zhvillimit rural, si dhe hapa pozitiv në lidhje me qasjen Leader/CLLD, gratë dhe të rinjtë ruralë. Të ndërgjegjshëm jo vetëm për sfidat e mëdha të sektorit, por edhe të mundësive që ofron procesi i integritimit evropian dhe potencialeve të vetë zonave rurale, mbetemi të angazhuar për të rritur ndikimin në proceset e hartimit dhe zbatimit të politikave të zhvillimit rural dhe forcuar lidhjet dhe shkëmbimet me grupet e ndryshme të interesit dhe me popullatën rurale.

Evelina Azizaj
Koordinatorë Kombëtare

SHIFRA DHE FAKTE

2019

2 projekte afatgjata

2 afatshkurtra

750 numri i pjesëmarrësve në aktivitete

4 workshope
rajonale mbi qasjen
Leader

2 evente kombëtare

5 trajnime (1 kombëtar|4 rajonal)

4 trajnime
dyditore mbi
aftësitë e buta dhe
TIK për të rinjtë

3 workshope udhëtuese

1 karvan mbi sipërmarrjen e gjelbër

1 analizë monitoruese

19 persona kyç të ftuar

AKTIVITETE

2019

TRYEZA KOMBËTARE MBI QEVERISJEN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL solli së bashku rreth 80 pjesëmarrës nga gjithë vendi për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm mbi sfidat dhe çështjet e rëndësishme të politikave kombëtare të sektorit.

KATËR WORKSHOPE RAJONALE ‘Përvojat ekzistuese dhe perspektiva për zbatimin e qasjes Leader në territor’ mblodhën 120 pjesëmarrës. Workshopet u organizuan në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

GRATË NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

ANRD përpiqet të promovojë barazinë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave rurale për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. –

EDICIONI I PRO-GRAVE RURALE i organizuar me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale me 15 tetor 2019. Ky edicion që synon të kthehet në një traditë të përvitshme, synon të rrisë ndërgjegjësimin për rolin e rëndësishëm dhe kontributin e grave rurale në bujqësi dhe zhvillimin rural, dhe njëherësh për të tërhequr vëmendjen e të gjithëve për mbështetje të qëndrueshme në adresimin e sfidave me të cilat përballen gratë rurale në vendin tonë.

LËVIZJA RINORE RURALE

ANRD me Qendrën e vet Burimore për të rinjtë rural (RURAL YOUTH HUB) paraqet një 'formë' të re për aktivizmin rural. Synimi lidhet me krijimin dhe fuqizimin e një rrjeti të të rinjve rurale për të lidhur nisma, grupe dhe përpjekje të limituara dhe të izoluara në nivel lokal me procese zhvillimore në nivele më të larta, për të nxitur dhe fuqizuar lëvizjem rinore rurale në Shqipëri. Qendra do t'i mundësojë të rinjve rurale të ushtrojnë "zërin" e tyre dhe të ndikojnë në vendimmarrjen rurale, për t'i bërë proceset e tilla të orientuara nga rinia dhe të lidhura ngushtë me nevojat dhe interesat e rinisë rurale.

20 entuziastë të rinj nga 17 fshatra të Shqipërisë morrën pjesë në workshopin udhëtues “Realiteti i të rinjve në zonat rurale ndërmjet sfidave dhe aspiratave për të ardhmen” dhe diskutuan sfidat më të rëndësishme me të cilat përballen të rinjtë në Shqipërinë rurale.

PESË TRAJNIME (NJË ToT KOMBËTAR DHE 4 RAJONAL) të zhvilluara me temën “Advokacia dhe lobimi, hulumtimi dhe analiza e politikave kombëtare dhe europiane mbi qasjen Leader/CLLD”.

KATËR TRAJNIME DYDITORE MBI AFTËSITË E BUTA DHE TIK për të rritur aksesin e të rinjve në tregun e punës në zonën e Dibrës, për të përmirësuar integrimin e tyre në tregun e punës.

NJË TRAJNIMIN KOMBËTAR DY DITOR “Qeverisja e mirë e OSHC-ve: Menaxhimi financiar, prokurimi dhe diversifikimi i fondeve”.

KARVANI I SIPËRMARRJES SË GJELBËR u konceptua si një seri aktivitesh të njëpasnjëshme në trajtën e një karvani me synim ndërgjegjësimit e publikut mbi konceptin e ekonomisë dhe sipërmarrjes së gjelbër në nivel vendor dhe evropian.

ÇERTIFIKOHEN 5 TRAJNERËT E PARË NË SHQIPËRI MBI QASJEN LEADER! 5 përfaqësues të ANRD të trajnuar dhe certifikuar, kanë krijuar bërthamën e parë të profesionistëve nga Rrjetet Rurale Kombëtare të Ballkanit Perëndimor që do të transmetojnë dhe qartësojnë në nivel të komuniteteve rurale parimet e CLLD (Zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti) dhe qasjen LEADER.

TRE WORKSHOPE UDHËTUESE DYDITORE me synimin e krijimit të një rrjeti mbështetësish, aktivistësh, sipërmarrësish nga shoqëria civile, qeverisja, organizatat anëtare dhe joanëtare të ANRD, sipërmarrjes që kanë interes dhe janë të angazhuar në nisma e aksione që synojnë mirëqënien e jetës së banorëve të zonave rurale. Përzgjedhja e pjesëmarrësve në këtë aktivitet është bërë duke u nisur nga kjo ide.

ANRD gradualisht ka intensifikuar përpjekjet në monitorimin dhe analizën e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural në Shqipëri. ANRD synon të inkurajojë pjesëmarrjen e publikut në procesin e negociatave të pranimit të Shqipërisë në BE. Gjatë 2019, fokusi i analizës dhe monitorimit ishte zbatimi i Planit Kombëtar të Integritimit Evropian, Kapitulli 11 – Bujqësia dhe Zhvillimi Rural. Raporti i monitorimit të shoqërisë civile mbi zbatimin e Kap.11 i cili u finalizua në fund të 2019 përmbledhi këtë analizë.

PUBLIKIME

2019

LETRA E POZICIONIMIT MBI QEVERISJEN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Letra e Pozicionimit synon të trajtojë problematikat dhe mangësitë kryesore të kuadrit kombëtar të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural dhe të ofrojë rekomandime për adresimin e barrierave që pengojnë instrumentet mbështetëse të sektorit të jenë efektive për të dhënë rezultate konkrete dhe të qëndrueshme në kohë. Për këtë, letra e pozicionimit sjell një perspektivë kritike të qeverisjes së sektorit me qëllimin për të përmirësuar qasjet dhe metodologjinë e hartimit, rishikimit dhe zbatimit të politikave kombëtare të zhvillimit bujqësor dhe rural në frymën e PBB-së. Në këtë kontekst, procesi konsultues (mbi të cilën u mbështet hartimi i dokumentit) u realizua i udhëhequr nga parimet e instrumentit të politikës së BE për zhvillimin rural - Zhvillimin Vendor të Udhëhequr nga Komuniteti (CLLD) - si një formë e re e zhvillimit të zonave rurale dhe demokracisë me pjesëmarrje. <https://anrd.al/wp-content/uploads/2018/12/ANRD-PolicyPaper2019-AL.pdf>

THIRRJE E RRJETIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL

DIALOGU KOMBËTAR MBI QEVERISJEN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL –
DOMOSDOSHMËRI JETIKE

Shoqëria civile, biznesi dhe përfaqësuesit e institucioneve vendore ftojnë Komisionin Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucione të tjera publike të **NDËRTOJNË DIALOG** të vazhdueshëm për të diskutuar sfidat dhe barrierat që pengojnë politikat dhe instrumentet mbështetëse të sektorit për të qenë efektive dhe për të gjetur zgjidhje të mundshme sa më shpejt të jetë e mundur. <https://anrd.al/publikime/thirrje-e-rrjetit-shqiptar-per-zhvillimin-rural/>

PLATFORMA E PRSH II

PARLAMENTI II RURAL SHQIPTAR 2020|PERSPEKTIVA EUROPIANE E SHQIPËRISË RURALE

Platforma e Parlamentit Rural Shqiptar është një praktikë gjithëpërfshirëse që synon të influencojë dhe përshpejtojë proceset reformuese në sektorin rural për revitalizimin e komuniteteve rurale. Platforma e PRSH II u prezantua në tetor 2019 në eventin e Pro Grave Rurale. <https://anrd.al/parlamenti-ii-te-rural/>

RAPORTI MONITORUES

Raporti Monitorues i Shoqërisë Civile mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) | Kapitulli 11 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural.

Raporti synon të përshkruajë gjendjen e zbatimit të PKIE, Kapitulli 11 - Bujqësia dhe Zhvillimi Rural për periudhën 2009-2019 dhe të ofrojë rekomandime të bazuara në evidenca për të inkurajuar debatin publik mbi përafrimin e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri me ato të

BE-së. Ndërkohë që theksi është tek zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim - Asocimit (MSA), bashkë me kapacitetet për përafrimin ligjor dhe institucional, ky raport siguron gjithashtu një vështrim të detajuar të trendeve të kaluara dhe të ardhshme të bujqësisë dhe zhvillimit rural në kontekstin e integrimit në BE, me fokus tek Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB). <https://anrd.al/evente-anrd/progresi-dhe-sfidat-ne-perafrimin-e-agiendes-evropiane-te-zhvillimit-rural-dhe-bujqesor-ne-shqiperi/>

REZOLUTA E YOUTH HUB NË SHQIPËRINË RURALE

Si rezultat i diskutimeve të të rinjve pjesëmarrës gjatë workshop-it udhëtues, Qendra Burimore e të rinjve ruralë hartoi këtë rezolutë për të shprehur interesat dhe aspiratat e tyre. Ne u bëjmë thirrje vendimmarrësve kombëtarë dhe lokalë, organizatave të zhvillimit rural dhe palëve të tjera të interesuara të respektojnë nevojat e të rinjve dhe të nxisin aspiratat tona. <https://anrd.al/lajme/lancimi-i-anrd-youth-hub-permes-eorkshop-it-udhetues/>

BULETINI I PËRDYMUJSHËM ANRD

Buletini shënon një instrument dhe mundësi më shumë për të ndarë punën e ANRD dhe të anëtarëve të saj, për të mbajtur kontakt me aktorët kryesor të punës sonë si një mënyrë për të ndërtuar edhe besimin me ta. Numri i parë i buletinit u përgatit gjatë muajit tetor 2019.

Nr. I i Buletinit të përdymuajshëm (tetor 2019)

Nr. II i Buletinit të përdymuajshëm (dhjetor 2019)

RRJETËZIM

2019

ANRD ka investuar në rrjetëzim në nivele të ndryshme si dhe ndërtimin e kapaciteteve të anëtarëve të vet në kuadër të dinamikave rajonale dhe evropiane të rrjeteve rurale dhe aktorëve të tjerë. Në këtë aspekt, përfaqësues të organizatave të ANRD dhe aktorëve të tjerë kanë marrë pjesë në aktivitete rajonale dhe evropiane.

RRJETËZIMI 10 VJECAR NË ZHVILLIMIN RURAL

“NetworX – inspiring rural Europe” një aktivitet i suksesshëm i ENRD – Rrjetit Evropian të Zhvillimit Rural, u zhvillua gjatë datave 11-12 Prill 2019 për të njohur arritjet 10 vjeçare të rrjetëzimit rural evropian. Ndër më shumë se 450 pjesëmarrës nga gjithë Evropa e më tej, prezent ishin edhe përfaqësues të rrjeteve rurale të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural.

PARLAMENTI I 4RT EVROPIAN RURAL DHE PARLAMENTI I 2-TË I TË RINJVE

Parlamenti i katërt Evropian Rural – Zëri i Evropës rurale të dëgjohet – u zhvillua në Spanjë, nga 6-9 nëntor 2019. Eventu mbledhi rreth 355 pjesëmarrës nga 40 vende, nga të cilët pesë ishin nga Shqipëria dhe tre prej tyre përfaqësues të ANRD-së. Parlamenti u ndoq nga shumë të rinj të cilët organizuan Parlamentin e dytë rinor rural nga 4-6 nëntor.

VIZITË STUDIMORE MBI LEADER/CLLD

Dy përfaqësues të emëruar nga ANRD (një nga ANRD dhe një përfaqësues i GLV) morën pjesë në një vizitë ekspozimi në Austri për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në lidhje me zbatimin e suksesshëm të qasjes LEADER/CLLD. Vizita synon transferimin e përvojës evropiane në lidhje me formulimin, planifikimin, zbatimin, organizimin, financimin dhe monitorimin e metodave CLLD / LEADER.

KONFERENCA SHKENCORE E PRAKTIKUESVE TË PARË TË QASJES LEADER

Dy përfaqësues të ANRD morën pjesë në konferencën shkencore të praktikuesve të parë të qasjes LEADER që u fokusua në ndikimet praktike dhe akademike në shpalosjen e programit LEADER në Evropën Jug-Lindore. Konferenca u organizua në nëntor 2019 në Opatija, Kroaci. Eventu mbledhi akademikët dhe praktikuesit LEADER nga e gjithë Evropa, por kryesisht vendet/ territoret e Evropës Jug-Lindore dhe përfaqësoi një mundësi për të synuar më tej projektet dhe nismat e ndryshme për të nxatur zhvillimin social dhe ekonomik të rajonit. Dy përfaqësues të emëruar nga ANRD morën pjesë në këtë event.

FORUMI I POLITIKAVE RURALE

Një përfaqësi prej katër të rinjsh nga ANRD morën pjesë në Forumin e politikave rurale që u organizua në kuadër të projektit ALTER. Forumi i këtij viti kishte në qendër temën e të rinjve në zonat rurale.

PARLAMENTI I PARË RURAL NË MAQEDONINË E VERIUT

Pesë përfaqësues nga ANRD morën pjesë dhe ndoqën Parlamentin e parë Rural në Republikën e Maqedonisë së Veriut, aktivitet që mbledhi rreth 80 pjesëmarrës në një event dy ditor.

EVENTI RAJONAL MBI DITËN NDËRKOMBËTARE TË GRAVE RURALE, MAQEDONIA E VERIUT

Tre përfaqësuese nga ANRD morrën pjesë në eventin rajonal të organizuar mbi Ditën Ndërkombëtare të Grave Rurale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

WORKSHOP RAJONAL “Programi për ngritje kapacitetesh për shërbimin ekstensiv në Ballkanin Perëndimor për të mbështetur pjesëmarrjen në thirrjet e IPARD”

Një përfaqësues nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural mori pjesë në workshopin rajonal të mbajtur në datat 16-20 shtator 2019 në Beograd, Serbi “Programi për ngritje kapacitetesh për shërbimin ekstensiv në Ballkanin Perëndimor për të mbështetur pjesëmarrjen në thirrjet e IPARD”, i cili u organizua nga Standing Working Group në bashkëpunim me Area Science Park dhe mbështetur nga nisma e Evropës Qendrore (CEI). Pjesëmarrës në këtë workshop ishin përfaqësues të Autoriteteve Menaxhuese, Agjensive të Pagesave, Shërbimeve të Ekstensionit dhe Rrjeteve kombëtare të Zhvillimit Rural të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

GRUPI RAJONAL PËR BARAZINË GJINORE

GRUPI RAJONAL PËR BARAZINË GJINORE përfaqëson një ekip profesional me një anëtarësi prej 14 anëtarësh, 2 përfaqësues nga çdo rrjet rural në vendet e Ballkanit Perëndimor. Takime, trajnime dhe workshope janë organizuar dhe është hartuar Dokumenti i Politikës së Komunikimit për Barazinë Gjinore të BRDN (Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin Rural) si dhe Plani i Veprimit të grupit rajonal për barazinë gjinorë (2020-2022). Përfaqësues të ANRD kanë kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në këtë proces.

REGJISTRIMI FORMAL I RRJETIT BALLKANIK PËR ZHVILLIMIN RURAL

Në fund të vitit 2019 u regjistrua zyrtarisht Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin Rural, ku ANRD është anëtar më të drejta të plota. Regjistrimi formal i BRDN është arritje e një procesi takimesh dhe diskutimesh të vazhdueshme ndër vite të rrjeteve rurale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kohë është zhvilluar statuti dhe procedurat për funksionimin dhe menaxhimin e strukturave drejtuese dhe menaxhuese të BRDN.

PJESËMARRËSIT NDAJNË

2019

*“Çdo të thotë të jesh
grua rurale?
Heroina të heshtura që
punojnë 24 orë në punë
të papaguar. Gruaja
rurale duhet të dijë
edhe si gatuhet buka,
edhe si rritet gruri”.*

Valentina Pashollari
AgriNet ALBANIA,
Edicioni i Parë i "Pro Grave Rurale", 15
tetor 2019

*“Ne vendosëm që të
ndalojmë së shkruari
letra të
papërfunduara. Të
vetmet luftëra të mira
dhe paqe të këqija -
përpyekjet tona, me
shtrëngime duarsh.”*

Gent Imeraj
Aleanca e Alpeve Shqiptare
Koordinator ANRD Rural Youth Hub

“Ju falenderoj shumë që më bëtë pjesë të këtij aktiviteti dhe të prezantoj se si unë e mendoj të ardhmen e zonës sime; se si unë mund të bëj më shumë për të kontribuar në zhvillimin e zonës time. Nuk ka politika mbështetëse për zhvillimin e ekonomisë rurale; e vetmja strukturë në luginën e Dishnicës në Këlcyrë që ka ndikim pozitiv në ekonomitë e vogla bujqësore të fshatrave është Ferma jonë. Vetëm jemi të pafuqishëm. Ndaj, ju falenderoj që na bëni të ndjehemi pjesë të procese zhvilluese përtej zonës tonë”.


Elona Bejo, Sipërmarrëse, Ferma 'Grand AlbaNik' në Këlcyrë, Përmet
Pjesëmarrëse në Travelling workshop

MEDIA SOCIALE

2019



Page likes: 1196
Page followers: 1202



Femra 48%



Meshkuj 52%



48% e ndjekësve të faqes janë femra ndërsa 52% e tyre janë meshkuj.



Pjesa më e madhe e ndjekësve të ANRD në Facebook i përkasin moshës 25-34 vjeç.

Grupmosha	13-17	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
% e ndjekësve	0.4%	14%	40%	24%	13%	5%	2.6%



535 persona të rinj pëlqyen faqen e ANRD në Facebook. Rritja konsiston në 45% më shumë ndjekës përgjatë vitit 2019.



Ndjekësit e faqes së ANRD në Facebook jetojnë në 45 shtete të ndryshme. Pjesa më e madhe e tyre jetojnë në Shqipëri, Itali, Kosovë, Gjermani, Greqi, SHBA, Mbretërinë e Bashkuar dhe Maqedoninë e Veriut.



Postimi më popullor i faqes së ANRD në facebook i përket Workshop-it udhëtues nëpër rrugën e verës dhe ullirit i cili u organizua në 14-15 nëntor në komunitetet rurale të qarqeve Tiranë dhe Durrës.

POSTIMET MË POPULLORE TË 2019:

- ✚ Tryeza Kombëtare vijon procesin mbarëkombëtar konsultues mbi qeverisjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural, dhe vjen në funksion të advokacisë për çështjet e adresuara në Letrën e Pozicionimit, ndarë tashmë me të gjithë aktorët përfaqësues të zhvillimit rural. (13 Janar)
- ✚ Rezervoni datën:
Tryezë Kombëtare mbi Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, do të zhvillohet me 12 shkurt 2019, ora 14.00. (31 Janar)
- ✚ Duke ndodhur: "Tryezë Kombëtare mbi Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural" (12 Shkurt)
- ✚ "Me udhëtimin, vjen të kuptuarit"#Momenteinspiruese nga workshopi Udhëtues "Partneritete për zhvillimin e qëndrueshëm rural" (22 Korrik)
- ✚ "Të zbulosh nuk do të thotë thjesht të udhëtosh larg për të gjetur gjëra të reja, mjafton të shikosh me sy tjetër çfarë natyra dhe njeriu ka krijuar edhe pranë teje" (8 Nëntor)
- ✚ Workshop udhëtues nëpër rrugën e verës dhe ullirit u organizua në 14-15 nëntor në komunitetet rurale të qarqeve Tiranë dhe Durrës. (18 Nëntor) Posti më popullor i vitit 2019.
- ✚ Realiteti i të rinjve në zonat rurale ndërmjet sfidave dhe aspiratave për të ardhmen. Duke filluar nga dje, e enjte 12 dhjetor deri nesër, e shtunë 14 dhjetor, një grup të rinjsh entuziastë për zhvillimin rural kanë shënuar fillimin e lëvizjes rinore rurale në Shqipëri. Pjesëmarrësit janë angazhur në një program dinamik treditor për t'i dhënë përgjigje pyetjeve: Cili është realiteti, nevojat dhe sfidat e të rinjve shqiptarë? Cilat janë aspiratat e tyre? Në ç'mënyrë politikat rurale mund t'i përgjigjen perspektivës së tyre? Cfarë mund të bëjë rinia për të ndikuar në proceset dhe reformat për të përmirësuar jetesën dhe të ardhmen e tyre rurale?
Na ndiqni për t'u informuar mbi Rezolutën e të rinjve të RURAL YOUTH HUB (Qendra Burimore e të Rinjve Ruralë) për mirëqënie më të mirë të komuniteteve rurale dhe status të përmirësuar social-ekonomik të të rinjve ruralë. (13 Dhjetor).

PROJEKTET

2019

PROJEKTI “KONSOLIDIMI I ROLIT TË RRJETIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL drejt një modeli funksional të perspektivës me pjesëmarrje dhe poshtë-lart në agjendën kombëtare rurale” është një projekt 32 mujor, financuar nga Bashkimi Evropian, i cili ka filluar të zbatohet që nga muaji shkurt 2018. Projekti zbatohet nga tre organizatat themeluese dhe ndër më aktivet të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) dhe ndërtohet mbi vizionin e tyre të përbashkët për pjesëmarrjen civile në politikëbërjen rurale. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim udhëheq zbatimin e projektit, në partneritet me organizatën AgriNET dhe AgroPUKA. Projekti synon të rrisë impaktin dhe përmirësojë përfshirjen e OSHC-ve dhe Rrjeteve të OSHC-ve (dhe aktorëve të tjerë ruralë) për të advokuar dhe influencuar hartimin dhe zbatimin e politikave rurale në vend.

“Në sajë të projektit, ANRD dhe anëtarët e saj janë aktorë të rëndësishëm në një seri nismash konkrete dhe procesesh që avancojnë interesat dhe prioritetet e komuniteteve rurale si dhe përshpejtojnë proceset reformuese të sektorit drejt modeleve dhe praktikave zhvillimore pozitive europiane”.

PROJEKTI NAGE – RRJETËZIM DHE ADVOKIM PËR EKONOMINË E GJELBËR – është një projekt trevjeçar, financuar nga Bashkimi Evropian, i cili zbatohet nga konsorciumi i rrjeteve rurale në vendet e Ballkanit Perëndimor që veprojnë së bashku në interes të anëtarëve të tyre përmes Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin Rural (BRDN). Rrjeti i Zhvillimit Rural i Republikës së Maqedonisë së Veriut po udhëheq zbatimin e projektit NAGE në partneritet me rrjetet në vijim:

Qëllimi i përgjithshëm i NAGE është të ofrojë mbështetje për të rritur ndikimin politik dhe vendimmarrës të BRDN dhe të anëtarëve të saj, përmes përfshirjes në proceset e reformimit të programeve dhe politikave rurale e bujqësore me synim përfshirjen e konceptit të ekonomisë së gjelbër. Projekti NAGE do të arrijë qëllimin e tij nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve në punën e përgjithshme të tyre, në advokim dhe rrjetëzim, për të qenë në gjendje të përballojnë rolin e tyre si avokatë të reformës bujqësore dhe rurale, në një mënyrë transparente dhe llogaridhënëse duke futur konceptin e ekonomisë së gjelbër si një model sipërmarrës unik ndërsektorial për diversifikim rural dhe qëndrueshmërinë.

“NXITJA E AFTËSIVE KOMPJUTERIKE DHE KOMUNIKUESE TEK TË RINJTË NË ZONAT RURALE PËR TË PËRMIRËSUAR INTEGRIMIN E TYRE NË TREGUN E PUNËS” është një projekt i financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë, dhe mbështetur nga UNDP Albania. Projekti është afatshkurtër dhe shtrihet në një periudhë kohore prej tre muajsh. Projekti synon të pajisë të rinjtë në zonën e Dibrës me njohuritë dhe aftësitë e domosdoshme që nevojiten për të patur akses në tregun e punës dhe mundësi të tjera zhvillimi.


Aktivitetet e parashikuara në projekt synojnë të ndikojnë në fuqizimin dhe mobilizimin e publikut, rritjen e kapaciteteve të të rinjve të zonës; mobilizimin e komunitetit lokal nga grupet në bazë;

rritja e ndërgjegjësimit mbi përdorimin e TIK dhe aftësive të komunikimit, dhe mjeteve të nevojshme për punësim; partneritete të reja dhe të forta, dhe inkurajimin e kulturës mbi modele dhe kompetenca të reja punësimi.

“STANDARTET E CILËSISË SË USHQIMIT DHE Pjesëmarrjen e FERMERËVE NË ZINXHIRËT MODERN TË FURNIZIMIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR” – një projekt studimor i ndërmarrë nga Njësia e "Ekonomisë Bujqësore" në Qendrën e Përbashkët Kërkimore (JRC) të Komisionit Evropian. JRC ka kontraktuar kompaninë italiane PANGEA scc për të zbatuar dhe drejtuar studimin, i cili ka si objekt kryesor identifikimin e faktorëve që ndikojnë në pjesëmarrjen e fermerëve në zinxhirët modern të furnizimit si dhe marrëveshjet kontraktuale ndërmjet përpunuesve/shitësve për të siguruar furnizimin me cilësinë e dëshiruar nga tregu. Studimi, ndër të tjera, përfshinte realizimin e një sondazhi me 2.205 fermer në 7 vendet e përfshira në këtë projekt. Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural është organizata lokale zbatuese për Shqipërinë.


PROJEKTET TONA

2016-2020



BUXHETI

2019



*EU NAGE përfshin komponent rigrantimi për OSHC-të vendore